

Vendim nr. 116 datë 30.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 30.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FLORJAN HAJDINI**, përfaqësuar nga avokat Denion Bogdani, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2187 (352), datë 19.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, shkronjat “b” dhe “ç”, 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Florjan Hajdini ka ushtruar detyrën e drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale (*ALUIZNI*). Pas kallëzimit nga ana e këtij institucioni, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 2342 të vitit 2014 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 Kodit Penal (*KP*), në ngarkim të kërkuesit dhe shtetasit A.S. Në përfundim të hetimeve ka rezultuar se këta të fundit kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, duke legalizuar objekte që nuk duhej të ishin legalizuar, duke sjellë, në këtë mënyrë, pasoja të rënda për shtetin dhe shtetasit shqiptarë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në gjykimin e çështjes me procedurën e gjykimin të shkurtuar, me vendimin nr. 1611, datë 18.05.2016, për kërkuesin, ka vendosur deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe dënimin e tij me 1 vit e 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të *KP*-së, ky dënim është pezulluar, duke u vendosur në provë për një periudhë kohe prej 18 muajsh. Sipas kësaj gjykate, kërkuesi ka konsumuar veprën penale për të cilën akuzohej në rastin e legalizimit të 7 objekteve dhe një shtese kati në favor të një shtetaseje në qytetin e Tiranës në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi dhe i pandehuri tjetër.

3. Me vendimin nr. 1015, datë 17.04.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1611, datë 18.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të kërkuesit për shkak se nuk provohej fajësia. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs prokuroria.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2187 (352), datë 19.12.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1015, datë 17.04.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1611, datë 18.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Në datën 15.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuessit

6. *Kërkuessi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi objekt kundërshtimi i ka cenuar:

6.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1.1. *Së drejtës për t'u njoftuar, dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi kërkuessi nuk është njoftuar për rekursin e ushtruar nga prokuroria ndaj vendimit të gjykatës së apelit dhe as për vendimin e arsyetuar të kësaj gjykate, qoftë edhe me shpallje. Dëftesa e komunikimit të rekursit është nënshkruar nga avokati A.P. që ka mbrojtur kërkuessin vetëm në seancën e fundit gjyqësore të zhvilluar në gjykatën e apelit në datën 17.04.2018. Ky avokat nuk ka pasur tagra përfaqësimi përtej zhvillimit të kësaj seance gjyqësore, pasi kërkuessi është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur prej tij. Në vijim, edhe Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për shqyrtimin e rekursit, si dhe ka njoftuar për vendimin e arsyetuar avokatin A.V., që kishte përfaqësuar kërkuessin në disa seanca në gjykatën e apelit.

6.1.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi mosnjoftimi i rekursit pas pushimit të çështjes në ngarkim të tij nga gjykata e apelit i ka mohuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë me kundërrekurs ose memorie me shkrim. Kjo gjykatë nuk ka verifikuar tagrat e përfaqësimit.

6.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi kërkuessit nuk i është dhënë mundësia për t'u mbrojtur përpara Gjykatës së Lartë ose të kundërshtojë rekursin e paraqitur nga prokuroria.

6.1.4. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të standardit për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ndonëse gjykimi në gjykatën e apelit ka përfunduar në vitin 2018, shqyrtimi i rekursit nga Gjykata e Lartë është bërë pas 5 vjetësh.

6.1.5. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë është shprehur për pretendimet e prokurorisë, duke bërë vlerësim të provave, sikurse një gjykatë fakti, duke dalë përtej pozicionit të saj si gjykatë ligji. Ajo ka zhvlerësuar aktin e ekspertimit, ndonëse ai shprehet se objektet e legalizuara nuk përfshihen në zonën historike të qytetit, duke paracaktuar vlerën provuese të tij. Në rast se kjo gjykatë nuk ishte e bindur për provat, ajo duhet ta kthente çështjen për rigjykim në gjykatat më të ulëta. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është i pavend, pasi as gjykatat më të ulëta dhe as kërkuessi nuk kanë pretenduar

se moszbatimi i një akti nënligjor nuk përbën veprë penale. Gjithashtu, ajo nuk ka argumentuar nëse pranimi i rekursit lidhet me pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave. Arsyetimi i asaj gjykate bazohet vetëm në argumentet ligjore të ngritura nga prokuroria në rekurs, argumente të cilat nuk qëndrojnë, pasi janë bazuar në parashikime ligjore të cilat janë miratuar në periudhë të mëvonshme se sa momenti i kryerjes së veprës penale.

- 6.2. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi Gjykata e Lartë ka zhvilluar një gjykim të njëanshëm, duke i rënduar pozitën procedurale kërkuesit dhe duke paragjykuar çështjen e tij. Kjo gjykatë kishte detyrim të shtuar për garantimin e standardeve kushtetuese në kushtet kur kërkuesi është deklaruar i pafajshëm me një vendim të formës së prerë.
- 6.3. *Lirinë personale*, pasi kërkuesit nuk i është njoftuar rekursi i prokurorisë dhe ai ka pasur pritshmëri për situatën procedurale penale të tij, duke mbajtur në vëmendje kohën e gjatë që ka kaluar nga momenti i shpalljes së vendimit të gjykatës së apelit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen

objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të standardit për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi, ndonëse gjykimi në gjykatën e apelit ka përfunduar në vitin 2018, shqyrtimi i rekursit nga Gjykata e Lartë është bërë pas 5 vjetësh. Në lidhje me këtë pretendim, nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, nuk rezulton që kërkuesi t’i jetë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, sipas neneve 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Referuar përmbajtjes së ankimit kushtetues, ai nuk ka parashtruar asnjë argument se këto mjete nuk janë efektive për mbrojtjen e së drejtës së tij për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, si një aspekt i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet në lidhje me këtë pretendim, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive. Për sa u përket pretendimeve të tjera, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 19.12.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 15.04.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar, dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe standardit të arsytimit të vendimit, si dhe parimit të prezumimit të pafajësisë dhe lirisë personale. Për sa u përket këtyre të fundit, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka paragjykuar çështjen, ndonëse kishte detyrim të shtuar për garantimin e standardeve kushtetuese dhe se ai kishte pasur pritshmëri për situatën procedurale penale, për sa kohë është deklaruar i pafajshëm me një vendim të formës së prerë. Në këtë drejtim, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuesit lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, Kolegji vlerëson t'i analizojë ato në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

13. Në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, argumentet e kërkuesit lidhen me mosnjoftimin e rekursit të ushtruar nga prokurori ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Për këtë shkak ato do të trajtohen në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe asaj për t'u mbrojtur.

14. Kolegji vëren se për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit kërkuesi ka paraqitur dy argumente: *së pari*, Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të provave sikurse një gjykatë fakti dhe në rast se kjo gjykatë nuk ishte e bindur për provat ajo duhej ta kthente çështjen për rigjykim në gjykatat më të ulëta; *së dyti*, arsytimi i Gjykatës së Lartë ishte i pavend, pasi as gjykatat më të ulëta dhe as kërkuesi nuk kanë pretenduar se moszbatimi i një akti nënligjor nuk përbënte vepër penale; ajo nuk ka argumentuar nëse pranimi i rekursit lidhej me pavlefshmërinë e vendimit, akteve ose papërdorshmërinë e provave dhe arsytimi i asaj gjykate bazohej vetëm në argumentet ligjore të ngritura nga prokuroria në recurs, të cilat janë të pabazuara. Referuar përmbajtjes së këtyre argumenteve, Kolegji vlerëson se argumenti i parë lidhet me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, ndërsa argumenti i dytë me standardin e arsytimit të vendimit, të cilat do të analizohen të ndërlidhura midis tyre.

15. Për sa më lart, Kolegji çmon të analizojë në vijim pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur

16. Kërkuesi ka pretenduar se nuk është njoftuar për rekursin e ushtruar nga prokuroria ndaj vendimit të gjykatës së apelit dhe as për vendimin e arsyetuar të kësaj gjykate, qoftë edhe me shpallje. Dëftesa e komunikimit të rekursit është nënshkruar nga avokati A.P., që ka mbrojtur kërkuesin vetëm në seancën e fundit gjyqësore të zhvilluar në gjykatën e apelit në datën 17.04.2018. Ky avokat nuk ka pasur tagra përfaqësimi përtej zhvillimit të kësaj seance gjyqësore, pasi kërkuesi ishte mbrojtur nga një avokat i zgjedhur prej tij. Në vijim, edhe Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për shqyrtimin e rekursit, si dhe ka njoftuar për vendimin e arsyetuar avokatin A.V., i cili kishte përfaqësuar kërkuesin në disa seanca në gjykatën e apelit. Sipas kërkuesit, mosnjoftimi i rekursit pas pushimit të çështjes në ngarkim të tij nga gjykata e apelit i ka mohuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë me kundërrekurs ose memorie me shkrim. Gjithashtu, atij nuk i ishte dhënë mundësia për t'u mbrojtur përpara Gjykatës së Lartë ose për të kundërshtuar rekursin e paraqitur nga prokuroria.

17. Në jurisprudencën kushtetuese Gjykata ka evidentuar rëndësinë e së drejtës për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, e cila u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Gjithashtu, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016; nr. 21, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen. Ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 41, datë 18.09.2023; nr. 13, datë 12.03.2023; nr.17, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Lidhur me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata është shprehur se ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34 datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se nga dosja gjyqësore rezulton se në seancën e datës 28.10.2015 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkuesi ka deklaruar se do të përfaqësohej nga avokati A.V., i cili ka qenë prezent në disa seanca. Më pas, në seancën e datës 21.01.2016 kërkuesi ka kërkuar të përfaqësohej edhe nga avokati A. P. me të gjitha tagrat edhe në mungesë. Të dy këta përfaqësues kanë mbrojtur kërkuenin në vijim deri në marrjen e vendimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u paraqitur vetëm ose së bashku.

20. Ndërsa në gjykimin në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkuesi është përfaqësuar nga avokati A.V., i cili nga 14 seanca që janë zhvilluar për gjykimin e çështjes, ka marrë pjesë në 5 prej tyre. Gjithashtu, rezulton se në seancën e fundit të datës 17.04.2018 është paraqitur avokati A.P., i cili ka paraqitur mbrojtjen përfundimtare. Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për deklarimin fajtor të kërkuetit dhe pushimin e gjykimit për të. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs prokuroria, për të cilin rezulton të ketë marrë dijeni avokati A.P. nëpërmjet dëftesës së komunikimit të datës 09.07.2018.

21. Në vijim, rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 55321-01626-00-2018, datë 10.10.2018. Me urdhrin e datës 17.11.2023 relatori i çështjes ka vendosur shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit në datën 19.12.2023 dhe ka urdhëruar sekretarinë të kryejë shpalljen e njoftimit dhe njoftimin e palëve për orën dhe datën e gjykimit. Referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se në datën 17.11.2023 është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit, në të cilën ndodhet edhe emri i kërkuetit. Data e shqyrtimit të rekursit për çështjen e kërkuetit i është komunikuar nëpërmjet adresës elektronike avokatit A.V. në datën 17.11.2023, ndërsa në procesverbalin e datës 19.12.2023 Gjykata e Lartë është shprehur se palët ndërgjyqëse në proces kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit me anë të shpalljes publike dhe nuk rezulton të kenë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për përbërjen e trupit gjykues. Rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë objekt kundërshtimi që ka vendosur prishjen e vendimit

të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për fajësinë e kërkuesit i është komunikuar në adresën elektronike të *e-mail*-it avokatit A.V.

22. Kolegji konstaton se, referuar nenit 436, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale (KPP) sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Krahas njoftimit me shpallje, kjo dispozitë parashikon edhe njoftimin individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit. Këto rregulla janë detajuar edhe në urdhrin nr. 131, datë 02.07.2021 “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”, të nxjerrë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë. Ndërsa, sipas nenit 436/a, pika 1, të KPP-së shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit.

23. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se kërkuesi në procesin gjyqësor të zhvilluar kundër tij ka zgjedhur të mbrohet me dy avokatë, edhe në mungesë të tij, të cilët e kanë mbrojtur atë në gjykimin në shkallë të parë dhe në apel, qoftë veçmas, ashtu edhe së bashku. Për sa i përket rekursit të prokurorit, rezulton se ai i është njoftuar njërit prej avokatëve të zgjedhur nga kërkuesi. Në vijim, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë ka bërë njoftimin për datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit jo vetëm përmes shpalljes në mjediset e saj dhe faqes zyrtare, por edhe në adresën elektronike të mbrojtësit tjetër të zgjedhur nga kërkuesi. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi është njoftuar rregullisht për rekursin e prokurorit dhe se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale të zbatueshme për njoftimin e palëve dhe publikimin e datave të shqyrtimit të çështjeve në atë gjykatë.

24. Në kontekstin e këtyre rrethanave, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka pasur dijeni për rekursin e ushtruar nga prokurori dhe për ditën e gjykimit të çështjes së tij në Gjykatën e Lartë, ndaj, për rrjedhojë, ka pasur mundësinë që të paraqesë argumentet e tij për çështjen. Prandaj, pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

25. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë është shprehur për pretendimet e prokurorisë duke bërë vlerësim të provave, sikurse një gjykatë fakti, duke dalë përtej pozicionit të saj si gjykatë

ligji. Ajo ka zhvlerësuar aktin e ekspertimit, ndonëse ai shprehej se objektet e legalizuara nuk përfshiheshin në zonën historike të qytetit, duke paracaktuar vlerën provuese të tij. Në rast se kjo gjykatë nuk ishte e bindur për provat, ajo duhej ta kthente çështjen për rigjykim në gjykatat më të ulëta. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është i pavend, pasi as gjykatat më të ulëta dhe as kërkuesi nuk kanë pretenduar se moszbatimi i një akti nënligjor nuk përbën veprë penale. Gjithashtu, ajo nuk ka argumentuar nëse pranimi i rekursit lidhej me pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave. Arsyetimi i asaj gjykate bazohet vetëm në argumentet ligjore të ngritura nga prokuroria në rekurs, argumente të cilat nuk qëndrojnë, pasi janë bazuar në parashikime ligjore të cilat janë miratuar në periudhë të mëvonshme se sa momenti i kryerjes së veprës penale.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë është theksuar se në ushtrimin e funksionit si gjykatë e ligjit, ajo gjykatë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i gjykatës së faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimin në shkallët më të ulëta gjyqësore, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 57, datë 09.11.2023; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 44, datë 19.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 15.03.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht

arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se gjykatat e faktit kanë arsyetuar në mënyrë diametralisht të kundërt në lidhje me fajësinë e kërkuesit. Kështu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se ai ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohej, pasi sipas aktit të ekspertimit 7 objektet e legalizuara përfshiheshin në zonën brenda aksit kryesor dhe qendrës historike të Tiranës, të shpallur monument kulture me VKM-në nr. 180, datë 13.04.2000 “Për shpalljen ansambël monument kulture të aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës” (VKM nr. 180/2000). Gjithashtu, sipas gjykatës, ndonëse ekspertja ka konstatuar se sipas konfigurimit të qendrës historike të Tiranës të vënë në dispozicion nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), objektet nuk përfshihen brenda kësaj zone, por midis këtij kufiri dhe atij të miratuar me VKM-në nr. 180/2000, kjo e fundit nuk është shfuqizuar. Pavarësisht se ky akt ka dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 7867, datë 12.10.1994 “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme e të paluajtshme” (ligji nr. 7867/1994), ligj i cili është shfuqizuar shprehimisht nga neni 55 i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, kjo nuk sjell automatikisht edhe shfuqizimin e VKM-së nr. 180/2000. Sipas kësaj gjykate, një akt i tillë që rregullon marrëdhëniet juridike në një fushë të caktuar shfuqizohet shprehimisht nga ligjvënësi në dispozitat e fundit të ligjit të ri që rregullon këto marrëdhënie. Në kushtet kur VKM-ja nuk është shfuqizuar shprehimisht ajo është ende në fuqi, pra dhe objektet e legalizuara ndodhen brenda një zone që ka statusin “ansambël monument kulture” dhe, referuar ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (ligji nr. 9482/2006) ato nuk mund të legalizohen. Për më tepër shtetit i janë shkaktuar pasoja financiare, pasi individët që kanë rezultuar pronarë të këtyre ndërtimeve janë dëmshpërblyer për interes publik. Ndërsa për sa i përket rastit të legalizimit të një shtese kati, është provuar se objekti pa leje është ndërtuar mbi një objekt tjetër të katit të parë, për truallin e të cilit është vendosur urdhërkufizimi për moskryerjen e asnjë veprimi. Po kështu, sipas gjykatës, ligji nr. 9482/2006 zbatohet pas datës 02.05.2013 vetëm nëse procedura e legalizimit nuk kërkonte kalim pronësie mbi truallin (*shih faqet 8-11 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

29. Përkundrejt këtij qëndrimi, gjykata e apelit ka vlerësuar se prokuroria nuk ka bërë asnjë analizë për faktet ose interpretimet që ta bëjnë atë të besojë ekzistencën e dashjes si formë e fajit.

Për më tepër, veprimet e kërkuesit janë konsideruar të paligjshme bazuar në VKM-në nr. 180/2000, të dalë në zbatim të një ligji i cili është shfuqizuar dhe rrjedhimisht termi “ansambël monument kulture” i përdorur në këtë ligj dhe në VKM nuk ekziston më. Konkretisht, sipas nenit 38 të ligjit nr. 9482/2006 institucioni përkatës që përcakton zonën ose objektet monument kulture për efekt të legalizimit është IMK-ja. Ekspertja e pyetur nga prokuroria ka arritur në përfundimin se sipas konfigurimit të dërguar nga ky institut zona ku ndodhen ndërtimet e legalizuara nuk përfshihen brenda zonës historike, përfundim të cilin prokuroria nuk e ka paraqitur në kërkesën për gjykim. Për rrjedhojë, nuk ekzistojnë elementet përbërëse të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”. Ndërsa për sa i përket rastit të dytë nuk përmbushet elementi i anës subjektive të veprës penale, pasi problematika e evidentuar nuk përkon me detyrat dhe kompetencat e drejtorit rajonal, por me punën e vartësve të tij. Në përfundim, gjykata e apelit ka vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të kërkuesit për shkak se nuk provohej fajësia (*shih faqet 4-7 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

30. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin e rekursit të prokurorisë, ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk ka përmbushur detyrimin për zbatimin korrekt të ligjit material ose procedural penal. Sipas kësaj gjykate, shfuqizimi i ligjit nr. 7867/1994 nuk sjell *ipso jure* edhe shfuqizimin e VKM-së nr. 180/2000, pasi humbja e fuqisë juridike të një akti administrativ bëhet me akt të shprehur nga organi që e ka nxjerrë aktin. Për rrjedhojë, statusi “ansambël monument kulture” i zonës brenda së cilës ndodhen objektet e legalizuara konsiderohet në fuqi derisa të hiqet shprehimisht me një VKM ose ligj tjetër. Në fakt, me VKM-në nr. 325, datë 12.04.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth” (*VKM nr.325/2017*) është shfuqizuar shprehimisht VKM-ja nr. 180/2000, çka nënkupton se kjo e fundit ka qenë në fuqi deri në datën 20.04.2017 kur është botuar në Fletoren Zyrtare VKM-ja nr. 325/2017. Për rrjedhojë, kërkuesi gjatë ushtrimit të detyrës në vitin 2013 kishte detyrimin të zbatonte VKM-në nr. 180/2000. Po kështu, edhe argumenti tjetër i gjykatës së apelit se zona monumentale përcaktohet sipas nenit 38 të ligjit nr. 9482/2006 është i pabazuar, pasi ky nen parashikon se IMK-ja dërgon pranë ALUIZNI-it inventarin e zonave ose objekteve monument kulture së bashku me kufijtë përkatës, brenda të cilave procesi i legalizimit të shtesave ose ndërtimeve pa leje përjashtohet për shkak të mbrojtjes së veçantë që gëzohet me ligj. Më tej, Gjykata e Lartë është shprehur se fakti që sipas aktit të ekspertimit ka rezultuar se zona ku ndodhen objektet e legalizuara nuk përfshihet në zonën historike sipas hartës së

administruar nga IMK-ja, nuk përbën argument, pasi heqja e statusit “ansambël monument kulture” zonës brenda së cilës përfshihen 7 objektet e legalizuara duhet të bëhej me akt të shprehur nga organi që e ka nxjerrë aktin që i ka dhënë më parë këtë status. Ndërsa në lidhje me rastin e dytë, për legalizimin e shtesës së katit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se legalizimi është kryer jo vetëm për një objekt të ngritur në truallin në pronësi të një personi tjetër, por ajo ka pasur edhe kufizim regjistrimi, për rrjedhojë kërkuesi mban përgjegjësi penale (*shih paragrafët 29, 38-45 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

31. Nga sa më lart, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë i është referuar aktit të ekspertimit, sipas të cilit zona ku ndodhen objektet e legalizuara nuk përfshihet në zonën historike sipas hartës së administruar nga IMK-ja, duke mos e pranuar si argument në favor të kërkuesit, pasi ka vlerësuar se VKM-ja nr. 180/2000 ka qenë në fuqi në kohën e legalizimit të ndërtesave dhe ky akt i ka dhënë statusin “ansambël monument kulture” zonës brenda së cilës janë objektet e legalizuara. Në të njëjtin konkluzion ka arritur edhe gjykata e shkallës së parë, e cila ka evidentuar këtë konstatim të ekspertës dhe ka analizuar fuqinë juridike të VKM-së nr. 180/2000. Për këtë shkak, nuk rezulton se Gjykata e Lartë të ketë ripërcaktuar faktet ose të ketë nxjerrë konkluzion të ndryshëm për to në raport me atë të gjykatës së shkallës së parë. Në këtë rast, kontrolli i Kolegjit Penal është fokusuar vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të gjykatave të faktit, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit prej tyre.

32. Gjithashtu, Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë kundërthënie dhe të mos ketë respektuar standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor. Interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë në drejtim të fuqisë juridike të aktit nënligjor në zbatim nuk rezulton të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm në kuptimin kushtetues, që të cenojë drejtësinë e procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.